

VENDIM
Nr. 117, datë 16.11.2011

MBI ANKANDIN MUJOR TË ALOKIMIT TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT
PËR MUAJIN DHJETOR 2011

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 7 germa “b” të “Modelit të tregut të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.11.2011, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “KESH sh.a.”, lidhur me alokimin e kapaciteteve për muajin dhjetor 2011,

Konstatoi se:

KESH sh.a., mund të përballlet me një situatë të përkeqësimit të kushteve hidroenergjetike për shkak të një thatësire të tejzgjatur, ç’ka do të vështirësonte mbulimin e nevojave me energji elektrike të konsumatorëve tariforë,

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Ankandi i alokimit të kapaciteteve të interkoneksionit për muajin dhjetor 2011, të kryhet vetëm për pjesën e mbetur të kapaciteteve pas sigurimit të nevojave të shoqërisë KESH sh.a. në përputhje me kërkesën e paraqitur nga kjo kompani për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit për muajin dhjetor.

2. OST sh.a. të sigurojë alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit për muajin dhjetor për nevoja të KESH sh.a., duke përfshirë edhe kapacitetet e pashfrytëzuara nga “CEZ shpërndarje” nga të drejtat e siguruara.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë KESH sh.a. dhe OST sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani